



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4882/3 Prot

Rrëshen më, 30 . 12 . 2024

V E N D I M

Nr. 115 datë 27.12.2024

**PËR
"MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË
PROJEKT BUXHETIT 2025 - 2027", BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 shkronja "b", pika 1/1.3 shkronja "a" dhe "c" nenit 41, nenit 54, shkronja "dh", nenit 55, pikat 3, dhe 6, të ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neneve 6, 15, 17 & 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); nenit 140, nenit 149, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 3, datë 28.02.202, e ministrisë Financave dhe Ekonomisë, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", Udhëzimin Plotësues nr. 8, datë 05.07.2024, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", Udhëzimet e ministrisë Financave dhe Ekonomisë për bashkitë pilot, VKB nr. 51, datë 15.12.2023, "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025", VKB nr. 24, datë 18.03.2024, "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", në shkresën e MF, Drejtoria e Përgjithëshme e Buxhetit, Drejtorisë së Financave Vendore dhe Sektoriale për vitin 2025, pas Dëgjësave Publike në çdo njësi administrative të Bashkisë Mirditë, Relacionit nr. 4458 prot, datë 27. 11. 2024, të përgatitur nga Zëdhënësja e Shtypit dhe Koordinatore për të Drejtën e Informimit, Relacionin nr. 4882 prot, datë 20.12.2024, mbi detajimin e planit të buxhetit - 2025, relacionin nr.4882/2 prot, datë 30.12.2024 dhe projekt/vendimin nr. 4882/1, datë 20.12.2024 të Kryetarit të Bashkisë, (drejtoria zhvillimit ekonomik, tatim-taksa), nga Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit të këshillit bashkiak, i mbledhur me datë 24.12.2024, ora 10.00, shqyrtoi draftin e buxhetit të vitit 2025 të bashkisë Mirditë, për t'a kaluar në mbledhjes të Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Buxhetin e Bashkisë Mirditë, për vitin 2025, dhe Dokumentin Përfundimtar të Projekt - Buxhetit Afatmesëm 2025 - 2027, të detajuar si më poshtë vijon;

**A. PLANET PËR VITIN 2025, TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR, TRANSFERTË
SEKTORIALE DHE TË ARDHURA TË PARASHIKUARA:**

NR	EMËRTIMI	SHUMA LEKË
1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR	278 816 285
2	RRITJA E NIVELIT TË PAGAVE	52 119 241
3	TRANSFERTA SPECIFIKE	216 795 544
4	TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA	85 000 000
	TOTALI (1+2+3+4)	632 731 070

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

B. SHPENZIMET TË NDARA SIPAS KATEGORIVE:

PROGRAMI	600	601	602	604	606	231	TOTALI
	Paga, shpërblime & tjera Personeli	Sigurimet shoqërore & shëndetësore	Mallra dhe shërbime	Transferta të brendshme	Transferta për buxh. famil. & indiv.	Aktive të trupëzuara	
AA133 Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë	106 319 880	17 755 420	23 320 787	2 600 000	700 000	4 200 000	154 896 087
AB133 Punët Publike dhe Mirëmbajtja	74 041 856	12 364 958	8 631 000	-	-	48 001 000	143 038 814
AC133 Siguria Publike	37 126 893	6 200 201	13 036 929	1 500 000	-	-	57 864 023
AD133 Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti	148 112 207	24 732 099	20 469 084	-	3 280 000	8 000 000	204 593 390
AE133 Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet	42 276 959	7 059 797	2 621 000	-	-	19 381 000	71 338 756
RK133 Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	-	-	-	1 000 000	-	-	1 000 000
TOTALI	407 877 795	68 112 475	65 478 800	5 100 000	3 980 000	82 182 000	632 731 070

**2. TË MIRATOJË TABELAT PËRFUNDIMTARE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2025 – 2027**

VITI 2025

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	475 990 270	75.23 %
2	Shpenzime Operaive	72 058 800	11.39 %
3	Investime	82 182 000	12.99 %
4	Fond i Emergjencës	1 500 000	0.24 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	1 000 000	0.16 %
	TOTALI	632 731 070	

VITI 2026

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	479 821 611	74.17 %
2	Shpenzime Operaive	83 306 787	12.88 %
3	Investime	81 250 781	12.56 %
4	Fond i Emergjencës	1 500 000	0.23 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	1 000 000	0.15 %
	TOTALI	646 897 179	

NR	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	SHUMA NË LEKË	%
1	Paga dhe Sigurime	482 265 784	72.66 %
2	Shpenzime Operaive	89 415 787	13.47 %
3	Investime	88 540 206	13.34 %
4	Fond i Emergjencës	2 482 000	0.37 %
5	Fond Rezervë dhe Kontigjence	1 000 000	0.15 %
	TOTALI	663 703 777	

3. Bashkia nga buxheti i saj do të mbulojë shpenzimet për karburant sipas kalendarit të ndeshjeve, siguracion jete, federim, pjesëmarrje në kualifikim e dy ekipeve sportive;
- ⬇ Ekipi Mirdita; volejboll për femra të rritura
 - ⬇ Ekipi Mirdita; volejboll për femra të rejat
4. Të gjitha të dhënat janë të sqaruara dhe të detajuara në relacion mbi detajimin e planit të buxhetit për vitin 2025, tabelat e buxhetit dhe PBA 2025-2027, (janë pjesë përbërse e këtij vendimi bashkëlidhur).
5. Plani i miratuar do të detajohet në muaj.
6. Për zbatim e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim takasave, drejtoria e burimeve njerëzore, juridike, prokurimeve dhe marrëdhënieve me qytetarët, drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit, agjencia e inspektimit, kontrollit dhe emergjencave, agjencia e punëve publike, mirëmbajtjes, agjencia e bujqësisë dhe administrimit të pyj dhe njësitë administrative).

Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë dhe i shtrinë efektet financiare, nga data 01 janar 2025.

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ




KRYETAR
Aleksander PICAË



G. Dopolaj
Dijoni
2025



Nr. 83 Prot
Dt. 03.01.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1/9 Prot.

Lezhë, më 08.01.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

D/ Zëlli Elm Nela Rrese
29. Vjolla Gashit

KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË MIRDITË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar"; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar ; ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr. 23 , datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgaditjes së PBA-së të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 115 , datë 27.12.2024 të Këshillit të Bashkisë Mirditë "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 dhe dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit 2025-2027", Bashkia Mirditë".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI



PERMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	5
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	7
2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË MIRDITË.....	9
2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	9
2.2 VLERËSIM I KUSHTEVE TË BASHKISË (ANALIZA SWOT)	10
3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË MIRDITË	12
3.1 VIZIONI I ZHVILLIMIT.....	12
3.2 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT DHE OBJEKTIVAT – SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT	13
4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË MIRDITE 2025-2027	14
4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË MIRDITË NË VITET 2025-2027	15
4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Mirditë për vitet 2025-2027	15
4.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Mirditë për periudhën 2025-2027.....	24
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR.....	41
5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE	44
5.1 PROGRAMI AA133 APARATI DHE DREJTIMI I BASHKISE	44
5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	47
5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	50
5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	54
5.1.4 Të Dhëna mbi Programin	55
5.2 PROGRAMI AB133 PUNET PUBLIKE DHE MIREMBAJTJA.....	57
5.2.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	60
5.2.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	63
5.2.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	71
5.2.4 Të Dhëna mbi Programin	72
5.3 PROGRAMI AC133 SIGURIA PUBLIKE	74
5.3.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	76
5.3.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	79
5.3.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	85
5.3.4 Të Dhëna mbi Programin	86
5.4 PROGRAMI AD133 ARSIMI, SHERBIMI SOCIAL, KULTURA DHE SPORTI.....	88
5.4.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	90
5.4.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	94
5.4.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	102
5.4.4 Të Dhëna mbi Programin	103
5.5 PROGRAMI AE133 BUJQESIA, VETERINARIA DHE PYJET	105
5.5.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	107
5.5.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit	110
5.5.3 Projektet e Investimeve të Programit.....	113
5.5.4 Të Dhëna mbi Programin	114
5.6 PROGRAMI AI133 FONDI REZERVË DHE KONTINGJENCË.....	116
6. BUXHETI I VITIT 2025.....	118

Lista e Tabelave

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Mirditë	14
Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit	16
Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.	25
Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike	29
Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funkcional (Niveli I, II, III i COFOG	32
Tabela AA133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike AA133.....	46
Tabela AA133-6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	48
Tabela AA133-7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit AA133	50
Tabela AA133-8. Projektet e Investimeve të Programit AA133.....	54
Tabela AA133-9. Të dhënat e Programit AA133.....	55
Tabela AB133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike AB133.....	58
Tabela AB133-6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit AB133	60
Tabela AB133-7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit AB133	63
Tabela AB133-8. Projektet e Investimeve të Programit AB133	71
Tabela AB133-9. Të dhënat e Programit AB133.....	72
Tabela AC133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike AC133.....	74
Tabela AC133-6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit AC133	76
Tabela AC133-7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit AC133.....	79
Tabela AC133-8. Projektet e Investimeve të Programit AC133.....	85
Tabela AC133-9. Të dhënat e Programit AC133.....	86
Tabela AD133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike AD133	89
Tabela AD133-6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit AD133.....	91
Tabela AD133-7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit AD133.....	94
Tabela AD133-8. Projektet e Investimeve të Programit AD133.....	102
Tabela AD133-9. Të dhënat e Programit AD133	103
Tabela AE133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike	106
Tabela AE133-6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit AE133	107
Tabela AE133-7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit AE133.....	110
Tabela AE133-8. Projektet e Investimeve të Programit AE133	113
Tabela AE133-9. Të dhënat e Programit AE133	114
Tabela AI133-5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike programi AI133.....	116
Tabela Buxheti 2025 - 1. Buxheti i Bashkisë 2025 sipas Programeve dhe Njësive Shpenzuese (në lekë)....	118
Tabela Buxheti 2025 - 2. Tavanet për çdo Program 2025-2027 (mijë lekë).....	121
Tabela Buxheti 2025 - 3. Parashikimi i të Ardhurave 2025-2027 (në lekë).....	123
Tabela Buxheti 2025 - 4. Totali i Shpenzimeve të Bashkisë sipas kategorive ekonomike (në lekë).....	127
Tabela Buxheti 2025 - 5. Numri i punonjësve sipas njësive shpenzuese të NJVV.....	129
Tabela Buxheti 2025 - 6. Numri i stafit të Bashkisë sipas Funksioneve të Qeverisjes.....	130

Lista e Figurave

Figura 1. Të Ardhurat e Bashkisë Mirditë sipas Burimit (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit).....	20
Figura 2. Shpenzimet e Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike.....	27
Figura 3. Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Funksioneve	40

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF	– Ministria e Financave
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV	– Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

1. HYRJJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifatat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje

jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njërive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësi vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përfundon me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë Mirditë

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Sipas Regjistrit të Gjendjes Civile 2014 Mirdita ka një popullsi prej 37,384 banorësh. Me një sipërfaqe prej 869.71 (867,1) km², bashkia e re ka një densitet prej 42.98 banorë/km².

Bashkia Mirditë gjendet midis koordinatave gjeografike 41° 43' e 41° 59' gjerësi veriore dhe 19° 43' e 20° e 12' gjatësi lindore, duke u kufizuar në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit dhe Dibres. Në jug-lindje kufizohet me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat dhe Kurbin ndërsa në jug-perëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit.

Bashkia përfshin 4 qytete dhe 81 fshatra, të shpërndara në 7 njësitë administrative përbërëse të saj: Rrësheni, Rubiku, Selita, Kthella, Fani, Oroshi dhe Kaçinari. Bashkia është aktualisht pjesë e qarkut të Lezhës.

Klima:

Klima është mesdhetare kodrinore, paramalore e malore. Bimësia është mjaft e pasur dhe përbëhet nga shkurre, dushqe, pyje të përzier, ahishte e kullota malore. Bimët mjekësore janë mjaft të përhapura. Nga pikpamja fizike territori karakterizohet nga formacione malore, lugina, pllaja, fusha, fushëgropa. Lartësia mesatare shkon 557 m mbi nivelin e detit, maja më e lartë është M. Kunorë (Selitë) (Jo Kunora, Mali i Dejes) 2121 m. Përshkohet nga lumenjtë Fani i Madh, Fani i Vogël, Uraka. Këta lumenj si dhe përrenj të tjerë malorë, kanë jo vetëm kapacitete prodhuese energjetike por edhe për kultivimin e faunes ujore.

Ekonomia:

Zona ka profil ekonomik kryesisht bujqësor dhe blegtoral, ndërkohë që vreshtaria po kthehet në një aktivitet mjaft të përhapur duke krijuar kushte shumë të mira për zhvillimin e agrobiznesit e agroturizmit. Ka pasuri të mëdha nëntokësore, veçanërisht bakër, pirit, krom, të cilat sollën krijimin e katër qyteteve të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie aktualisht është jashtë funksionit. Kjo është një nga arsytet që Mirdita shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm si dhe të emigrimit përgjatë 25 viteve të fundit. Për arsye se sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore, problemet ekologjike të zonës, janë kryesisht të lidhura me pyjet. Trashëgimia kulturore dhe etnografike është mjaft e larmishme dhe unike.

Pas ndërtimit të autostradës A1, Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë. Ndërtimi i Rrugës së Kombit megjithëse përmirësoi volumin e levizjes dhe cilësinë e udhëtimit, solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës, e cila ka nevojë për impulse të reja zhvillimi.

2.2 Vlerësim i kushteve të bashkisë (Analiza Swot)

Bazuar në të dhënat parësore dhe dytësore që tashmë janë grumbulluar dhe janë bërë objekt përpunimi dhe (c) përfundimet e takimit të hapjes, është krijuar fillimisht profili i bashkisë dhe është kryer një vlerësim paraprak i mjedisit social, ekonomik, natyror dhe kulturor i saj.

Si **avantazhe (Strengths)** të rëndësishme përmenden fillimisht sa më poshtë vijon:

- ✚ Avantazh i rëndësishëm i bashkisë përbën qasja e bashkisë pjesë konkrete të saj të cilat përshkohen nga aksi rrugor ndërore E851 që lidh Malin e Zi, Shqipërinë dhe Kosovën.
- ✚ Qasje të lehtë dhe të shpejtë me qendrën urbane Lezhë si edhe me kryeqytetin, duke lejuar në një numër të madh njerëzish të lëvizin përditë për të kërkuar punë edhe jashtë bashkisë.
- ✚ Burime të pasura natyrore dhe konkretisht burime ujore, minerale dhe pyje.
- ✚ Ekzistencë të monumenteve kulturore (arkitektonike dhe arkeologjike) dhe zona të mbrojtjes së tyre.
- ✚ Disponon mjedis të pasur, të pastër dhe të qetë natyror.
- ✚ Në mjedisin natyror me vlera përfshihen monumente të shpallura natyrore (VKM 676/2002), zona të mbrojtura dhe biodiversiteti.
- ✚ Interes të veçantë në lidhje me ujërat për përdorime të shumta: ujë të pijshëm, turizëm, (burime me ujëra termale, liqene), prodhim të energjisë elektrike, përdorim industrial
- ✚ Sektor i zhvilluar i shërbimeve (administrata shtetërore, shërbime sociale, tregti) në selinë e bashkisë.
- ✚ Projekte të rinovimit dhe rigjenerimit urban (p.sh. rikualifikim urban i sheshit, ndërtesa e re e bashkisë, krijimi i trotuareve, mbrojtje nga përmytjet, reformimi i tregut), duke e kthyer bashkinë në një qendër tërheqëse rajonale me qëllim për të mbajtur banorët dhe për të tërhequr banorë të rinj.

Më poshtë shënohen **pikat e dobëta (Weaknesses)** të Bashkisë dhe konkretisht:

- ✚ Lidhje problematike të rrugëve dytësore me selitë e njësive Administrative. Kërkohen ndërhyrje në varësi të përparësisë.
- ✚ Cilësi e ulët në rrjetet e tjera të infrastrukturës teknike.
- ✚ Sektori sekondar është dobësuar shumë. Deindustrializimi është mjaft i ndjeshëm, duke lënë shumë ndërtesa dhe zona joaktive dhe të degraduara.
- ✚ Ekonomia rurale është në shkallë të vogël dhe lokale dhe ka si qëllim konsumin familjar.
- ✚ Një pjesë e të ardhurave të banorëve është e bazuar në ndihmën financiare që banorët marrin nga të afërmit e tyre që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe nga shteti.
- ✚ Shpërndarje e ndërtesave të banimit jashtë kufijve të vendbanimeve.
- ✚ Kontrast i madh në ndërtim mes qendrave të mëdha të banimit (Rrëshen dhe Rubik), ku boshti është koherent dhe paraqet përdorime të shumëllojshme, ndërtesa të larta, rrugë të qarta dhe qendra ndërtimi dhe vendbanime rurale të cilat kanë bosht të shpërndarë, element që paraqet ndryshimet unike historike dhe krijimin e veçantë social.
- ✚ Mjedisi i pasur natyror është i njohur vetëm në grupe të kufizuara dhe më të specializuara vizitorësh-turistë.

Potenciali më i rëndësishëm i zhvillimit - mundësi (Opportunities) të rajonit, në raport edhe me ambientin e jashtëm, përmbledhen në:

- ✚ Tendanca të shtuara të zhvillimit të ekoturizmit, në rajon dhe jashtë tij.
- ✚ Veçanërisht pozitiv është se bashkia ka shprehur interes, ka planifikuar dhe përpunuar projekte për investime të reja në sektorë të ndryshëm (p.sh. të zhvillimit urban dhe rural, turizmit, mbrojtjen e mjedisit).
- ✚ Kufinj të ndjeshëm të tonifikimit dhe transformimit të aktivitetit bujqësor (p.sh. prodhimi i produkteve tradicionale dhe produkteve me origjinë vendore).
- ✚ Mundësi të mëdha stimuluese në sektorin e turizmit me drejtim kryesor agrotourizmin dhe turizmin malor me bazë burimet natyrore dhe mjedisin e bukur natyror dhe kulturor.

Së fundi, u vunë re disa **rreziqe (Threats)** për zhvillimin e bashkisë të cilat vijnë nga mjedisi i jashtëm:

- ✚ Reduktim i ndjeshëm i popullsisë së bashkisë që ka regjistruar 2 dekadat e fundit, veçanërisht në zonat rurale.
- ✚ Më shumë se gjysma e popullsisë jetojnë në dy qendrat më të mëdha urbane (Rrëshen, Rubik) - braktisja e zonave malore dhe e vendbanimeve të largëta.
- ✚ Politikë - strategji inekzistente kombëtare dhe rajonale për zonën malore (p.sh. mungesë e një kuadri për zhvillimin dhe stimujve).
- ✚ Financim inekzistent i ndërhyrjeve të synuara - paaftësi për përdorimin dhe shfrytëzimin e burimeve të disponueshme dhe potenciale. (p.sh. për arsye të mungesës së planifikimit, mungesës së strukturave të duhura bashkiake).
- ✚ Pamundësi për të përshtatur dhe birësuar standardet bashkëkohore në fermat bujqësore dhe blegtorale (p.sh. kosto e lartë, mungesë e institucioneve dhe praktikave të duhura).
- ✚ Dëshira e banorëve të rinj për tu larguar nga bashkia me qëllim plotësimin e dëshirave të tyre personale dhe gjetjes së punës.

Plani operacional(PZhS) përcakton 6 prioritete si ato që përmenden më poshtë:

1. Sigurimi i qasjes dhe përmirësimit të kushteve të jetesës së banorëve të Bashkisë përmes zhvillimit të infrastrukturës së përshtatshme.
2. Shfrytëzimi i avantazheve krahasuese të zonës në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë dhe zhvillimi i infrastrukturës moderne të mbështetjes për sektorët e mësipërm.
3. Zhvillimi i aktivitetit turistik dhe promovimi i tij si një nga sektorët kryesorë të ekonomisë së Bashkisë.
4. Fuqizimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë.
5. Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit përmes planifikimit hapësinor të integruar.
6. Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe arsimore me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të Bashkisë.

Me zgjerimin e përcaktimit të akteve prioritare dhe masave përkatëse, janë përcaktuar projektet indikative dhe programet e tyre për 3 vitet e ardhshme. Qëllimi i projekteve të planifikuara është zhvillimi i qëndrueshëm dhe i integruar hapësinor dhe ekonomik i Bashkisë së Mirditës.

3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë Mirditë

3.1 Vizioni i zhvillimit

Shqipëria është një vend mesdhetar. Klima e saj karakterizohet nga dimër i lagësht, i butë dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Regjimi i klimës ndikohet herë pas here nga sistemet atmosferike, si përplasje nga Oqeani Atlantik i Veriut dhe Deti Mesdhe, dhe anticiklone që vijnë nga Siberia dhe Azoret. Një faktor tjetër kyç që ndikon në klimën është afërsia me detin.

Duke marrë parasysh faktet reale, si edhe kërkesat që ata kërkojnë, siç edhe u pasqyruan dhe u vlerësuan në Fazën A' të studimit, përfshirë dhe analizën e mëparshme SWOT, përcaktohet vizioni i zhvillimit të Bashkisë për vitin 2032. Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë ka për qëllim të trajtojë dhe përballojë dobësitë dhe rreziqet që janë theksuar për rajonin e studimit dhe të shfrytëzojë avantazhet, si ato natyrore, ashtu edhe ato të përfituara nga mundësitë e paraqitura. Vizioni i zhvillimit të Bashkisë Mirditë për vitin 2032 është formuluar si më poshtë:

"Bashkia e Mirditës do të jetë një qendër shërbimi dhe përpunimi, bashkëkohor dhe konkurrues, bazuar në aksin trans-evropian Shqipëri-Kosovë (E851) dhe do të zhvillohet si pol i formave alternative të turizmit, bazuar në rezervat kulturore të shquara dhe burimet e pasura natyrore të saj".

Propozohet ringjallja ekonomike e rajonit, me qëllim që të bëhet një pol turistik bashkëkohor dhe konkurrues. Stimulimi i sektorit të turizmit do të arrihet duke e parë rajonin si një formë e zhvillimit të turizmit alternativ, duke përfituar nga rezervat e pasura kulturore, trashëgimia e veçantë arkitektonike e Bashkisë në kombinim me burimet e saj natyrore dhe duke identifikuar pozicionin kyç të Bashkisë.

Qëllimi i këtij studimi është që Bashkia e Mirditës të jetë një destinacion turistik, duke përfituar nga pozicioni i saj si një urë komunikimi midis bregdetit dhe rajoneve të brendshme të vendit. Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të turizmit, propozohet që Bashkia të drejtohet drejt formave alternative të turizmit, të tilla si (a) turizmi - fetar kulturor i cili do të bazohet në monumentet e shumta që Bashkia disponon në rajonin e saj (Orosi është një pol me monumente në këtë zonë) dhe ndërtesat e shquara arkitektonike (Kullat) dhe (b) në turizmin natyror dhe ekoturizmin që do të bazohet në mjedisin e pasur natyror të Bashkisë.

Në të njëjtën kohë, propozohet që të forcohet dhe të organizohet edhe sektori industrial (sektori sekondar) dhe ai i tregtisë (sektori terciar), veçanërisht në afërsi të zonave urbane Rrëshen dhe Rubik.

Forcimi sektorëve të mësipërm do të kryhet nëpërmjet zhvillimit të tyre të organizuar, në zona të caktuara ekonomike që do të propozohen dhe me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore të Bashkisë.

Së fundi, duhet të mbështetet edhe sektori i bujqësisë, kryesisht në zonat e njësive administrative Rrëshen, Kthellë dhe Selitë, të cilat janë zona me karakteristika rurale të spikatura dhe ku duket një dëshirë dhe vullnet i ruajtjes së veprimtarisë së tyre prodhuese.

Në këto zona propozohet forcimi i aktiviteteve rurale përmes promovimit të metodave ekologjiksht miqësore për prodhimin e produkteve të zonës, koordinimit dhe funksionimit të organizuara (p.sh. përmes kooperativave). Ky prodhim do të mund të zhvillohet dhe me krijimin e njësive agroturistike (të tilla si fermat rurale me gjënë e gjallë, gastronominë, etj.).

Në zhvillimin e rajonit të lart përmendur do të kontribuojë përmirësimi dhe integrimi i infrastrukturës dhe shërbimeve sociale, me synimin që banorët e Bashkisë të jetojnë në një mjedis të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshëm, i cili do të jetë tërheqës dhe do të ndihmojë në shmangien, zbutjen e fenomenit të migrimit drejt qyteteve të tjera. Në këtë mënyrë do të ketë mbajtje të numërit të popullsisë dhe përmirësim të cilësisë së jetës. Për më tepër, do të duhet që Bashkia, të jetë në gjendje të ofrojë si për banorët ashtu edhe për vizitorët e zonës mundësitë dhe infrastrukturën përkatëse (energjinë, telekomunikacionin, internet, etj.).

3.2 Strategjia e Zhvillimit dhe Objektivat – Sfidat kryesore të zhvillimit

Parimet kryesore udhëzuese për zbatimin e strategjisë së vizionit dhe zhvillimit të Bashkisë Mirditë janë renditur më poshtë si Objektiva Strategjike. Për çdo Qëllim Strategjik, shënohen në mënyrë treguese parametrat individualë që të çojnë në zbatimin e tij.

Objektivi strategjik 1: Rivitalizimi ekonomik i zonës përmes shfrytëzimit të pozitës kyçe të Bashkisë.

Objektivi strategjik 2: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Bashkisë.

Objektivi Strategjik 3: Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore.

Objektivi strategjik 4: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve.

4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË MIRDITË 2025-2027

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Mirditë gjatë periudhës 2025-2027, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2025-2027, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2025-2027. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Bashkia.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Mirditë

Raporti: PBA9 - Informacion mbi NJVQV
NJVQV: 133 - Bashkia Mirditë
PBA: 2025 – 2027

		Të Përgjithshme	2020	2021	2022	2023	2024
1	Numri i Njësive Administrative	7.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Numri i Fshatrave	82.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	867.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.1	Qyteti	1.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
3.2	Njësitë Administrative	866.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Sipërfaqja e NJVQV (km2)	867.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.1	Zonë Urbane	73.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.2	Tokë Bujqësore	63.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.3	Kullota	21.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.4	Pyje	710.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
4.5	Të tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Popullsia e NJVQV	0.00	37,384.00	37,384.00	37,384.00	37,384.00	37,384.00
5.1	Qyteti	0.00	15,968.00	15,968.00	15,968.00	15,968.00	15,968.00
5.2	Njësitë Administrative	0.00	21,416.00	21,416.00	21,416.00	21,416.00	21,416.00
6	Mosha Mesatare e Popullsisë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
7	Numri i Lindjeve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
8	Numri i Vdekjeve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

9	Numri i Bizneseve Aktive	0.00	418.00	440.00	440.00	440.00	440.00
10	Numri i Familjeve	0.00	4,591.00	4,546.00	4,508.00	4,503.00	4,503.00
10.1	Qyteti	0.00	2,834.00	2,787.00	2,753.00	2,753.00	2,753.00
10.2	Njësitë Administrative	0.00	1,757.00	1,759.00	1,755.00	1,750.00	1,750.00

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Mirditë në vitet 2025-2027

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Mirditë për vitet 2025-2027

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit
 Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave
 NJVQV: 133 - Bashkia Mirditë
 PBA: 2025 – 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL


	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 Plani Fillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	44,350	41,650	62,000	63,200	67,000	67,000	67,000
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	10,085	4,008	9,400	9,400	9,958	9,958	9,958
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	10,085	2,687	9,400	9,400	7,239	7,239	7,239
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	0	164	0	0	665	665	665
1.1.3	Taksa mbi truallin	0	1,157	0	0	2,054	2,054	2,054
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	0	0	0	0	0	0	0
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	3,297	1,730	3,000	3,000	2,500	2,500	2,500
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3,297	1,730	3,000	3,000	2,500	2,500	2,500
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	2,000	1,362	1,731	1,731	2,480	2,480	2,480
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	107	13	50	50	0	0	0
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	150	0	150	150	150	150	150
1.3.3	Taksa e tabelës	1,743	1,349	1,531	1,531	2,330	2,330	2,330
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	28,968	34,550	47,869	47,869	35,157	35,157	35,157
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	4,390	8,752	17,805	17,805	15,000	15,000	15,000
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	0	0	0	0	579	579	579
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	193	457	801	801	635	635	635
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	279	162	1,402	1,402	816	816	816
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	15,235	13,985	16,234	16,234	0	0	0

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 PlaniFillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	2,993	3,769	5,940	5,940	3,640	3,640	3,640
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	394	103	394	394	8,400	8,400	8,400
1.4.11	Tarifa e parkimit	0	0	0	0	0	0	0
1.4.12	Tarifa të tjera	5,484	7,322	5,293	5,293	6,087	6,087	6,087
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	0	0	0	0	16,906	16,906	16,906
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	0	0	0	0	16,906	16,906	16,906
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	0	0	0	1,200	0	0	0
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestime dhe zhdëmtime	0	0	0	0	0	0	0
1.6.3	Të tjera	0	0	0	1,200	0	0	0
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR	1,902,152	1,245,309	475,951	855,567	547,731	561,879	578,704

	Burimet Buxhetore	2022 Fakti	2023 Fakti	2024 Plani Fillestar	2024 Plani i Rishikuar	2025 Plani	2026 Plani	2027 Plani
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	188,222	159,070	284,746	296,651	330,936	344,188	360,100
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	188,222	159,070	265,539	265,539	278,816	292,069	307,981
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	0	0	19,207	31,113	52,119	52,119	52,119
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	149,606	155,774	191,205	198,888	216,796	217,691	218,604
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	19,978	20,763	23,463	23,463	24,167	24,650	25,143
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	45,894	48,295	55,109	61,383	72,323	72,323	72,323
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	17,134	17,955	20,624	20,624	21,448	21,448	21,448
2.2.4	Arsimi parauniversitar	7,404	8,571	9,316	9,316	9,688	9,688	9,688
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	18,950	15,866	24,401	25,810	28,749	28,749	28,749
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	10,742	13,823	18,069	18,069	18,790	18,790	18,790
2.2.8	Rrugët	20,172	20,789	23,163	23,163	23,889	24,301	24,721
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	9,332	9,712	17,060	17,060	17,741	17,741	17,741
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	0	0	0	0	0	0
2.2.12	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2.3	TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA	1,564,324	930,465	0	360,028	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	1,543,974	901,165	0	352,106	0	0	0
